


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7045
E shtunë, 11 nëntor 2023
Çmimi 0.50 €

Rashiti: Pa njohje
nuk ka normalizim
të mirëfilltë | **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PËR 11 MUAJ MBI 51 MIJË QYTETARË APLIKUAN PËR PASAPORTË

Nga 1 qershori i 2023-s deri më 6 nëntor mbi 51 mijë qytetarë kanë aplikuar për herë të parë për pasaportë. Në mesin e personave që kanë aplikuar dominojnë grupmosha 0-2 vjeç dhe grupmosha 18-22 vjeç, kështu është bërë me dije nga të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në disa agjenci turistike në Kosovë pohojnë se ka rritje të interesimit të qytetarëve dhe grupeve të organizuara për oferta të udhëtimit në vendet e Bashkimit Evropian, pas 1 janarit 2024 por, sipas tyre, nuk bëhet fjalë për ndonjë fluks masiv



AKTUALE



BLINKENI THOTË SE "DUHET TË BËHET MË SHUMË" PËR T'I MBROJTUR CIVILËT PALESTINEZË F. 2

FILLOJNË TË BIEN VLERAT E MANGANIT NË UJË, POR UJI ENDE I PAPIJSHËM F. 6

GJENDEN MBETJE MORTORE NË TUSUZ TË PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË LUFTËS F. 7

EKONOMI



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA 13.2 MILIONË EURO PËR REHABILITIMIN E UJËRAVE TË ZEZA F. 8

RAPORTI I PROGRESIT I KE-së PËR KOSOVËN VLERËSON ARRITJET NË MINISTRINË E INDUSTRIJËS F. 8

SPORT



PESË FUTBOLLISTË NGA SUPERLIGA NË LISTËN E KOSOVËS PËR NDESHJET E NËNTORIT F. 10

MUSTAFA: S'I BESOJ LDK-së, AS HAZIRIT QË S'E KANË PARË DRAFTIN E ASOCIACIONIT | **FAQE 3**



DAKA: ZGJEDHJET NË VERI MUND TË MBAHEN VETËM NËSE KRYETARËT JAPIN DORËHEQJE | **FAQE 5**



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Blinkeni thotë se “duhet të bëhet më shumë” për t’i mbrojtur civilët palestinezë

WASHINGTON, 10 NËNTOR - Sekretari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Antony Blinken, tha të premten se e ka mirëpritur pajtimin e Izraelit për paузë humanitare në ofensivën e tij në Gaza, por duhet të bëhet më shumë. “Shumë palestinezë janë vrarë. Ka shumë që kanë vuajtur javët e fundit. Ne duam të bëjmë gjithçka që është e mundur për ta parandaluar dëmtimin e tyre dhe për ta rritur ndihmën që u jepet atyre”, tha Blinkeni duke folur në Nju-Delhi.

Të enjten Shtëpia e Bardhë tha se Izraeli është pajtuar për paузë katërorëshe humanitare çdo ditë në veri të Gazës, ku po lufton me grupin palestinez Hamas, i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian.

Administrata e presidentit amerikan, Joe Biden, tha se ka siguruar një rrugë të dytë për civilët që të ikin nga luftimet. Presidenti Biden i kishte kërkuar kryeministrit izraelit Benjamin

Netanyahu që të vendoste paузë ditore. Këtë kërkesë ai e kishte bërë gjatë një bisede telefonike në fillim të kësaj jave.

Luftimet kanë shpërthyer në veri të Gazës që kur grupi ekstremist Hamas sulmoi komunitetet në jug të Izraelit dhe, sipas zyrtarëve izraelitë, vranë 1 400 njerëz dhe morën peng rreth 240 të tjerë, në atë që njihet si sulmi më i keq në historinë e vendit.

Izraeli më pas është hakmarrë me bombardime ajrore dhe ofensivë tokësore që, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Rripin e Gazës, të drejtuar nga grupi ekstremist palestinez, ka vrarë më shumë se 10 800 njerëz, në mesin e të cilëve shumë fëmijë.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, mirëpriti të enjten paузat, të cilat zyrtarizojnë një marrëveshje. “Unë mendoj se është bërë njëfarë progresi. Por unë, gjithashtu, isha shumë i qartë se duhet bërë më shumë për t’i



mbrojtur civilët dhe për dhënien ndihmë humanitare për ta”, tha Blinken. Sipas tij, paузat katërorëshe të dakorduara nga Izraeli, si dhe dy korridore humanitare, do t’i lejojnë njerëzit të largohen nga lufta. “Këta hapa

do të shpëtojnë jetë dhe do të mundësojnë më shumë ndihmë për të arritur te palestinezët në nevojë,” shtoi ai.

Vizita e Blinkenit në Indi është ndalesa e fundit e një udhëtimi maratonë që ka përfshirë Korenë

e Jugut dhe një takim të ministrave të Jashtëm të G7-s [shtatë vendeve më të industrializuara në botë] në Japoni. Atje ai synoi të gjente gjuhë të përbashkët për luftën Izrael - Hamas.

Stoltenbergu nuk e konsideron problematike afërsinë e Erdoganit me Hamasin



BRUKSEL, 10 NËNTOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, nuk sheh problem për aleancën, në rastet kur presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan shpreh mbështetje për grupin palestinez Hamas, i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja, i cili aktualisht është në luftë me Izraelin. “Nuk është asnjëherë e lehtë kur kemi pikëpamje të ndryshme brenda aleancës”, ka thënë Stoltenbergu në një intervistë për agjencinë e lajmeve dpa.

Shefi i aleancës ka thënë se, megjithatë, “kjo nuk ndikon në ndonjë mënyrë në atë që bëjmë, sepse ne nuk jemi duke luajtur rol në atë konflikt specifik”.

Pas sulmeve brutale të Hamasit në komunitetet izraelite më 7 tetor, në të cilat janë vrarë mbi 1 400 njerëz, Erdogani e ka përshkruar Hamasin si “grup çlirimtar”.

Si rezultat i luftës në Gazë, Erdogani i ka shkëputur kontaktet me kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanyahu. “Netanyahu nuk është më bashkëbisedues për ne në asnjë mënyrë. Ne e kemi fshirë atë, e kemi kryqëzuar”, ka thënë Erdogani.

Presidenti turk e ka përshkruar me raste Izraelin si “shtet terrorist” për shkak të trajtimit të palestinezëve dhe vazhdimisht e ka paraqitur veten kampion i

kauzës palestineze.

Deri më tani liderët e tjerë të NATO-s nuk janë dëgjuar duke e kritikuar Erdoganin.

Stoltenbergu i ka hedhur poshtë spekulimet se heshtja e anëtarëve të NATO-s mund të lidhet me mbajtjen peng të anëtarësimit të Suedisë në aleancë nga ana e Turqisë. “Këto janë dy çështje të ndara”, ka thënë ai.

Turqia dhe Hungaria janë dy vendet e vetme që ende nuk e kanë ratifikuar marrëveshjen për anëtarësim të Suedisë në NATO.

Turqia ankohet se Suedia nuk ka bërë mjaftueshëm për luftim të atyre që i quan militantë kurdë, një organizatë të të cilëve Ankaraja e konsideron terroriste.

Smogu toksik ngufat Pakistanin

LAHORE, 10 NËNTOR - Smogu toksik në lindje të Pakistanit i ka sëmure mijëra persona, duke i detyruar autoritetet t’i mbyllin disa qytete për gjithë javën.

Smogu në qytetin e dytë më të madh pakistanez, Lahore, është rritur në nivele të rrezikshme.

Qeveria provinciale e Punxhabit ka urdhëruar që shkollat, zyrat, qendrat tregtare dhe parqet në tri qytete, përfshirë Lahoren, të mbyllën deri të dielën.

Provinca Punxhab e Pakistanit është në kufi me shtetin indian me të njëjtën emër.

Është raportuar se edhe veriu i Indisë është duke vuajtur prej ndikimit të smogut toksik.

Disa banorë të Lahores kanë thënë për transmetuesin britanik BBC se atmosfera e tillë toksike është bërë e shpeshtë dhe u ndikon në shëndet dhe aktivitetet e tyre ditore. “Më duket se kjo atmosferë helmuese është

bërë pjesë e jetës sonë”, ka thënë shitësi Ameer Hamza, puna e të cilit ka të bëjë me bartje të mallrave me motoçikletë në pjesën më të madhe të ditës.

Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj smogut mund të çojë në dëmtime shëndetësorë, përfshirë edhe kancerin më mushkëri.

Disa ekspertë besojnë se djegia e fushave, për t’i përgatitur për sezonin e ri të mbjelljeve, është shkaktari kryq i ndotjes së ajrit.



Kurti në Paris takon kryetarin e Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës, flasin për zbatimin e marrëveshjes për lëvizjen me letërnjoftime

Prishtinë, 10 nëntor - Gjatë qëndrimit në Paris, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka zhvilluar një takim me kryetarin e Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës, Zeljko Komsic dhe anëtarin e Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës, Denis Becirovic.

Tema qendrore të bisedës ishin Procesi i Berlinit,

përkatësisht marrëveshjet e nënshkuara në kuadër të tij dhe përfitimet dhe domosdoshmëria e zbatimit të plotë të tyre, mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve dhe zhvillimet në rajon. Theks të veçantë nga ana e kryeministrit Kurti iu dha nevojës për zbatimin e marrëveshjes për lëvizjen e lirë me letërnjoftime të

nënshkuar në Berlin në nëntor të vitit të kaluar, e cila ende nuk është ratifikuar nga Bosnjë-Hercegovina.

Kryeministri Kurti, kryetari Komsic dhe anëtarin e Presidencës, Becirovic, gjithashtu diskutuan rreth mundësive dhe potencialit për shtim të bashkëpunimit në fushën e ekonomisë e të arsimit.



Mustafa: S'i besoj LDK-së, as Hazirit që s'e kanë parë draftin e Asociacionit

Ish-kryeministri Isa Mustafa beson se partitë opozitare e kanë parë draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, dokument ky i paraqitur në takimin me të dërguarin e BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak. Ish-kreu i LDK-së u shpreh i bindur të premten se nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, e ka konsultuar draftin sikurse edhe të gjithë krerët e opozitës që ishin në takim, duke shtuar se përfaqësuesi i BE-së nuk ka pasur arsye që dikujt t'ia paraqesë draftin e dikujt jo

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Ish-kryeministri Isa Mustafa beson se partitë opozitare e kanë parë draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, dokument ky i paraqitur në takimin me të dërguarin e BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak.

Ish-kryetari i LDK-së u shpreh i bindur se nënkryetari i kësaj partie, Lutfi Haziri, e ka konsultuar draftin sikurse edhe të gjithë krerët e opozitës që ishin në takim, duke shtuar se përfaqësuesi i BE-së nuk ka pasur arsye që dikujt t'ia paraqesë dokumentin e dikujt jo. Sipas Mustafës, çdo ndryshim e plotësim i bërë sa i përket draftit të Asociacionit duhet të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese. "Marrëveshje personale nuk ka, por ka nënshkrim personal, sepse marrëveshja e viti 2015 është ajo që siguron se statuti i Asociacionit duhet t'i nënshtrohet vlerësimit të

Gjykatës Kushtetuese dhe e mira e asaj marrëveshje është që një gjë të tillë e ka pranuar Serbia. Pra ka pranuar autoritetin e Gjykatës Kushtetuese. Vlerësimi i statutit jo vetëm në fazën e prurjes së tij, por edhe në të gjitha ndryshimet dhe plotësimet, duhet t'i nënshtrohet së njëjtës procedurë. Është një e arritur mjaft e madhe që duhet ta shfrytëzojë edhe qeveria, edhe Kurti, por jo vetëm ta shfrytëzojmë që të mbulohen me Gjykatën Kushtetuese, por t'i bëjnë të gjitha përpjekjet që statuti që shkon në Gjykatën Kushtetuese të jetë plotësisht në harmoni me Kushtetutën", ka thënë Mustafa.

Ish-lideri i LDK-së thotë se draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe nuk e ka parë, duke theksuar se atë duhet ta shohin deputetët dhe partitë opozitare.

Duke komentuar takimin e krerëve të partive opozitare me të deleguarin e Bashkimit Evropian për dialogun, Miroslav Lajçak, Mustafa



thekson se Memli Krasniqi, Lutfi Haziri e Ramush Haradinaj të martën e kanë parë draft-statutin, ndonëse Krasniqi e Haziri pas takimit mohuan një gjë të tillë. "Edhe pse nuk besoj se ato nuk e kanë parë, edhe pse po thonë se nuk

e kemi parë, sepse duan që të mbulohen për shkak të përgjegjësisë që kanë. Nuk mundet një përfaqësues i partisë opozitare ta shohë statutin në bisedë me Lajçakun e dy përfaqësues të tjerë mos ta shohin kur janë në të njëjtën

sallë. Lajçaku nuk ka zgjedhur që dikujt t'ia tregojë (draftin) e dikujt tjetër jo, por është një përgjegjësi. Nuk i besoj as Hazirit as përfaqësuesve të LDK-së që nuk e kanë parë draftin", ka thënë ish-kryeministri Isa Mustafa.

Në fund të javës së ardhshme pritet borë edhe në viset e ulëta

Prishtinë, 10 nëntor - Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në parashikimin e motit për ditët në vijim, ka bërë me dije se në fund të javës së ardhshme priten reshje bore edhe në viset e ulëta. Në njoftimin për medie bëhet me dije se, pas shiut që ra të mërkurën që lamë pas në sasi mbi mesatare, vendi ynë në

ditët në vijim dhe javën që vjen do të përshkohet me riga lokale shiu që do të jenë të shtuara në intensitet në intervale kohore të shkurtra, ndërkaq sipërfaqet në nivelet mbi 1200m lartësi mund të mbulohen edhe nga shtresa të cekëta bore. Temperaturat minimale do të sillen nga 03°C deri në 05°C, ndërsa temperaturat

maksimale nga 10°C deri në 13°C. Erërat do të jenë kryesisht jug-jugperëndimore, me rritje në intensitet përgjatë ditës nga 03 m/s deri në 20m/s. Ndërkaq, shtresat e petkut të bardhë, sipas modeleve në dispozicion, pritet të zënë vend në sipërfaqet e ulëta jo para fundit të javës së ardhshme.





Për 11 muaj mbi 51 mijë qytetarë aplikuan për pasaportë

Nga 1 qershori i 2023-s deri më 6 nëntor mbi 51 mijë qytetarë kanë aplikuar për herë të parë për pasaportë. Në mesin e personave që kanë aplikuar dominojnë grupmosha 0-2 vjeç dhe grupmosha 18-22 vjeç, kështu është bërë me dije nga të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në disa agjenci turistike në Kosovë pohojnë se ka rritje të interesimit të qytetarëve dhe grupeve të organizuara për oferta të udhëtimit në vendet e Bashkimit Evropian, pas 1 janarit 2024 por, sipas tyre, nuk bëhet fjalë për ndonjë fluks masiv

PRISHTINË, 10 NËNTOR - "Sot, po të kem mundësi, ec. Akshami s'do të më zinte këtu. Me padurim po e pres janarin". Me datën 1 të këtij muaji qytetarët e Kosovës do të mund të lëvizin lirshëm në dhjetëra vende të Evropës dhe Qëndrimi thotë se nuk mendon gjë tjetër veçse të udhëtojë drejt Gjermanisë të xhaxhallarët e tij. Si 25-vjeçar, ai është pajisur për herë të parë me pasaportë para dhjetë ditësh. Thotë se në Kosovë punon në një kompani private ndërtimi, e cila "nuk e paguan mirë". "Do të mundohem të punoj në Gjermani, njëherë nga tre muaj. Më vonë, shpresoj të mbes atje", thotë Qëndrimi, duke mos dashur të identifikohet edhe me mbiemër. Liberalizimi i vizave mundëson

udhëtime pa viza vetëm deri në 90 ditë - brenda gjashtë muajsh - në cilindo nga 27 shtetet anëtare të asaj që njihet si Zona Shengen. Por, udhëtimet e tilla duhet të shërbejnë vetëm për vizita turistike apo çështje familjare, dhe nuk nënkuptojnë assesi leje pune ose përfitime të tjera.

Më shumë aplikime për pasaporta

Sikurse Qëndrimi, edhe dhjetëra-mijëra qytetarë të Kosovës kanë aplikuar sivjet për herë të parë për pasaportë. Të dhënat që "Radio Evropa e Lirë" i ka siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës mbulojnë periudhën 1 qershor - 6 nëntor të këtij viti dhe, sipas

tyre, janë 51 365 qytetarë që kanë aplikuar për herë të parë për pasaportë. Krahasuar me shifrën e së njëjtës periudhë të vitit të kaluar, 48 791, bëhet fjalë për 2 574 aplikime më shumë. Në mesin e tyre dominojnë grupmosha 0-2 vjeç dhe grupmosha 18-22 vjeç. Ardi Ukaj, 21 vjeç, aplikoi në fund të tetorit për t'u pajisur me pasaportë, po ashtu për herë të parë. "REL"-i e takoi atë në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Prishtinë, në të cilën po interesohej nëse dokumenti i tij është gati. Edhe për të Gjermania është destinacioni i dëshiruar. "Por, si turist, për vizitë... Nuk punoj pa dokumente të rregullta, sepse ma ndalojnë hyrjen dhe nuk rrezikoj", thotë Ardi.

Ka interesim, por jo fluks masiv

Në disa agjenci turistike në Kosovë pohojnë se ka rritje të interesimit të qytetarëve dhe grupeve të organizuara për oferta të udhëtimit në vendet e Bashkimit Evropian, pas 1 janarit 2024 por, sipas tyre, nuk bëhet fjalë për ndonjë fluks masiv. Blerina Gashi, nga agjencia turistike ajrore "Eurokoha", thotë se në bazë të rezervimeve të deritashme, qytetarët në mesin e 20-tave janë më të interesuar për të udhëtuar. Fatmire Beqiri nga agjencia turistike "Veneta Travel" thotë se ka filluar tashmë përgatitjet për udhëtime të organizuara pas 1 janarit. "Interesimi për to është shumë i madh, pasi deri më tash ka pasur probleme për t'u pajisur me viza dhe shumë qytetarë as që kanë tentuar t'i grumbullojnë dokumentet e shumta për aplikim", sipas Beqirit. Ngjashëm pohojnë edhe në agjencitë që organizojnë udhëtime me autobusë. Ruzhdi Kurtishaj nga "Sharr Travel" thotë se interesimi i vërtetë për të udhëtuar pritet të

shihet nga dhjetori e andej.

Entuziazëm ka, por jo edhe mundësi ekonomike

Njohësi i integritimeve evropiane në Kosovë, Shenoll Muharremi, vlerëson se entuziazmi për të udhëtuar ekziston, por jo edhe mundësitë ekonomike. "Aktualisht jemi në një krizë të theksuar financiare të inflacionit dhe kjo mund ta zbehë potencialin e lëvizjeve", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë". Megjithatë, shton Muharremi, nuk përjashtohet mundësia që të rinjtë të interesohen ta braktisin Kosovën në kërkim të mundësive më të mira. Në vitet e fundit mijëra kosovarë kanë marrë viza pune për në vendet e BE-së, e sidomos në Gjermani. Vetëm vitin e kaluar numri i vizave të punës të lëshuara nga Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë është rritur për 110 për qind në krahasim me vitin paraprak. Mbi 21 mijë viza pune për Gjermani në katër vjet. Pasi ishte ulur numri i vizave të lëshuara

Maqedonci takohet me kryesuesin e ardhshëm të Komitetit të NATO-s, flasin për agresionin në Banjskë



Prishtinë, 10 nëntor - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, në kuadër të vizitës zyrtare në Itali, së bashku me ambasadorin e Kosovës në Itali, Lendita Haxhitasim, gjeneralmajor Gëzim Hazrolli si dhe këshilltaren politike Liridona Gashi, kanë

takuar admiralin Giuseppe Cavo Dragone, shef stafi i Mbrojtjes së Italisë dhe kryesues i ardhshëm i Komitetit të NATO-s. Ata kanë diskutuar për situatën aktuale gjeopolitike, zhvillimin e FSK-së, bashkëpunimin bilateral me Italinë në fushën e mbrojtjes

dhe synimin e Kosovës si shtet për anëtarësim në NATO dhe BE. "Admiralin e falënderova për bashkëpunimin e shkëlqyer të deritanishëm, për mbështetjen e vazhdueshme që Italia ka ofruar përmes trupave të KFOR-it dhe EULEX-it. Nga ana e tij, admiral

shprehu vlerësim të lartë për mënyrën se si është menaxhuar sulmi terrorist në veri të vendit, po ashtu shfaqti vullnet e gatishmëri të plotë për ta përkrahur Kosovën në rrugën drejt anëtarësimit në Programin e Partneritetit për Paqe", ka

shkruar Maqedonci në "Facebook". Të dy kanë vlerësuar se ruajtja e stabilitetit në Ballkan e më gjerë përbën prioritet, ndërsa koordinimi me partnerët tanë strategjikë është lidhja që e garanton këtë.

Daka: Zgjedhjet në veri mund të mbahen vetëm nëse kryetarët japin dorëheqje



Prishtinë, 10 nëntor - Ish-kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, ka thënë se zgjedhjet në veri të vendit mund të mbahen vetëm pas dorëheqjes së kryetarëve aktualë. Kjo çështje, sipas saj, mund të zgjidhet vetëm me një marrëveshje politike, por jo edhe me udhëzimin administrativ për largimin e kryetarëve nga funksioni i tyre. Për këtë dokument, Daka shprehet se nuk është kushtetues dhe që KQZ-ja nuk mund të organizojë diçka që

nuk ka mandat.

Udhëzimi administrativ që ua mundëson qytetarëve të veriut shkarkimin e kryetarëve përmes një peticioni u hartua nga qeveria për shtensionimin e plotë të situatës në veri të Kosovës. Ish-kryetarja e KQZ-së konsideron se ky dokument nuk do të ofrojë zgjidhje. Daka konsideron se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk mund të organizojë referendum meqë nuk është në mandatin e saj,

Megjithatë, ajo konsideron se duhet të ekzistojë një marrëveshje politike, meqë më shumë është çështje e tillë. Serbët e veriut kishin bojkotuar zgjedhjet e 23 prillit dhe më pas kanë kundërshtuar edhe kryetarët e zgjedhur në katër komuna. Më pas, Kosova kishte arritur marrëveshje me Bashkimin Evropian për ulje të tensioneve dhe në të është ishte përfshirë edhe mbajtja e zgjedhjeve të reja në veri. (Ksp)

për punë në Gjermani në vitin 2020, shkak i Covid-19, numri i tyre arriti shifër më të lartë në vitin 2022 sesa para pandemisë. Muharremi thotë se institucionet e Kosovës duhet të kujdesen për t'i informuar qytetarët se liberalizimi i vizave nuk nënkupton leje pune dhe, në rast se keqpërdoret, mund të ketë pasoja. "Disa gjëra marrin më shumë kohë për t'u zbatuar, andaj një komunikim më intensiv do ta ndihmonte publikun e gjerë të kuptojë se liberalizimi i vizave nënkupton më shumë turizëm dhe biznes, e jo punësim dhe në raste ekstreme kërkesa për azil", thotë

ai. Qeveria e Kosovës nga 5 tetori ka filluar fushatën informuese për liberalizimin e vizave, si në terren, ashtu edhe në mediet sociale. Klisman Kadiu, këshilltar politik i zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi, konfirmon për "REL"-in se materialet informuese janë shpërndarë në lokacione të ndryshme në gjuhët zyrtare të Kosovës. Sipas tij, fushata do të vazhdojë edhe pas janarit nëse është e nevojshme.

Rruga deri te liberalizimi

Kosova aktualisht është vendi i

vetëm në Ballkanin Perëndimor, qytetarët e të cilit nuk mund të lëvizin lirshëm në Zonën Shengen. Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia e Veriut e gëzojnë këtë të drejtë nga dhjetori i vitit 2009, ndërsa për Shqipërinë dhe Bosnjë-Hercegovinën kjo është bërë e mundur nga fundi i vitit 2010. Komisioni Evropian qysh në vitin 2018 ka konfirmuar disa herë se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave, por kanë qenë disa vende anëtare që vazhdimisht kanë shprehur rezerva. Vendimi përfundimtar për liberalizimin është marrë këtë vit,

përkatesisht në prill, kur është publikuar në Gazetën Zyrtare të BE-së. Megjithatë, Bashkimi Evropian e ka në dorë të ashtuquajturin Mekanizëm të pezullimit të vizave në rast se shkelen rregullat. Ai do të aktivizohet si vijon: Në rast të rritjes së konsiderueshme - mbi 50 % - të migrimit të parregullt; Në rast të rritjes së konsiderueshme - mbi 50 % - të kërkesave për azil me shkallë të ulët pranimi, rreth 3-4 %; Në rast të rënies së bashkëpunimit për riatdhesimin e shtetasve që përjashtohen nga BE-ja, si rezultat i qëndrimit të parregullt; Në rast të rrezikut të shtuar për

sigurinë e shteteve anëtare të BE-së, veçanërisht për vepra penale të rënda. Të dhënat e Agjencisë së BE-së për Azil tregojnë se vetëm gjatë vitit 2022 mbi 3 000 qytetarë të Kosovës kanë aplikuar për azil në një vend të këtij blloku dhe se kjo e drejtë u është njohur 8 për qind prej tyre. Agjencia e Statistikave e Kosovës nuk ka ende të dhëna për vitin 2022 dhe për këtë vit, por ato të vitit 2021 tregojnë se nga Kosova janë larguar mbi 42 mijë banorë për arsye të ndryshme, në mesin e tyre edhe punësimi. Sipas ASK-së, shumica e tyre kanë qenë legjalë.

Numri i operacioneve të kryera në Klinikën e Kirurgjisë Abdominale rritet për 25 %

Prishtinë, 10 nëntor - Ka shënuar rritje për 25 për qind numri i operacioneve të kryera nga kirurgët e Klinikës së Kirurgjisë Abdominale në QKUK. Sipas raportit të punës së kësaj klinike, në nëntë muajt e parë të vitit 2023 janë kryer 1 691 operacione, përfshirë operacione urgjente, por edhe ato të planifikuara në programin e rregullt operativ.

Duke iu referuar të njëjtit raport, janë kryer edhe 303 intervenime endoskopike (ERCP), 147 gastrokopi, 148 kolonoskopi dhe shërbime të tjera të natyrës kirurgjike. Në kuadër të intervenimeve kirurgjike elektive ka dominuar Holecistektomia laparoskopike (heqja kirurgjikale e fshikëzës së tëmthit), kurse te sëmundjet

urgjente ka dominuar trajtimi kirurgjik i apendicitit akut (zorra qorre) në kuadër të abdomenit akut si sindromë klinike.

Numri i intervenimeve kirurgjike të realizuara në nëntë muajt e parë të këtij viti është i barabartë, pothuajse me intervenimet kirurgjike të realizuara gjatë krejt vitit të kaluar.



Mbahet trajnimi me personelin shëndetësor të urgjencave të nivelit shëndetësor parësor të Prishtinës

Prishtinë, 10 nëntor - Në Qendrën e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë u organizua trajnimi i parë me personelin shëndetësor të urgjencave të nivelit shëndetësor parësor të kryeqytetit, në kuadër të fushatës për ngritjen e gatishmërisë profesionale të shërbimeve urgjente mobile të Prishtinës për bartjen e pacientëve të cilët dyshohen se kanë pësuar infarkt iskemik akut trunor deri te Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), në mënyrë që të realizohet ndërhyrja mjekësore e shpejtë për trajtimin e infarktit akut dhe minimizimit të pasojave të tij. Terapia trombolitike intravenoze dhe trombektomia mekanike janë dy mundësi të arta që aplikohen brenda dritares



kohore të përshtatshme të pacientët që pësojnë infarkt iskemik akut. Kushtet e parë të përfitimit nga terapia është që pacientët me këtë diagnozë të paraqiten, përkatësisht të sillen me kohë në Klinikën e

Neurologjisë në QKUK, ngaqë aplikimi i terapisë trombolitike intravenoze është i mundshëm nëse realizohet brenda 4.5 orëve nga çasti i paraqitjes së simptomave, kurse aplikimi i trombektomisë mekanike, sipas

rastit, mund të zbatohet brenda 24 orëve të para. Në këtë kontekst, njohja në vend të ngjarjes e simptomave të infarktit akut, transportimi sa më i shpejtë në qendrën spitalore dhe diagnostikimi rapid i mëtejme, shkurtojnë kohën deri te fillimi i terapisë dhe ky shkurtrim në kohën e fillimit të terapisë është jetik për pacientët me infarkt në tru.

Në kuadër të trajnimit të parë, personeli shëndetësor i urgjencave të kryeqytetit u informua nga ass. dr. Fisnik Jashari (koordinator i Projektit Kombëtar për Stroke) për rëndësinë e krijimit të vijës së veçantë me të cilën pacientët do ta tejkalojnë barrierën e vonësve infrastrukturore dhe kohore në Qendrën Emergjente

dhe për detajet e mekanizmit me të cilin synohet që pacientët me infarkt iskemik akut të mbërrijnë deri te terapia brenda disa minutash.

Ndërkaq ass. dr. Blerim Myftiu paraqiti rastet e përzgjedhura nga përvoja e deritanishme e terapisë trombolitike në Klinikën e Neurologjisë dhe dobinë që rastet e caktuara kanë fituar nga aplikimi i terapisë.

Drejtori i Klinikës së Neurologjisë, dr. Edmond Komoni, theksoi se Klinika e Neurologjisë është e gatshme për vëllimin e shtuar të punës dhe se zgjerimi i kapaciteteve të Klinikës për trajtimin e infarktit akut të trurit është elementi shtesë në kuadër të shumë projekteve që zbatohen dhe do të zbatohen në të ardhmen në këtë Klinikë.

Fillojnë të bien vlerat e manganit në ujë, por uji ende i papijshëm

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Në liqenin e Badocit ka filluar të ketë rënie të vlerave të manganit në ujë, por qytetarët ende nuk mund ta përdorin për pije, kanë konfirmuar Kompania Rajonale Ujësjellësi "Prishtina" dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Kosovë.

Arjeta Mjeku, zëdhënëse e KRU "Prishtina", tha për "Telegraf"-in se janë duke e përcjell gjendjen dhe se shpresojnë të përmirësohet. "Ne si KRU 'Prishtina' jemi duke bërë përpjekje maksimale për t'i furnizuar qytetarët me ujë të pijshëm përmes autoboteve në zonat e prekura. Jemi në koordinim të plotë me IKShPK-në.

Shpresojmë që situata të përmirësohet shumë shpejt dhe jemi në trend të rënies së vlerave të manganit, por jemi duke e përcjellë situatën në vazhdimësi. Gjendja nuk është alarmante", ka thënë ajo.

Mjeku tha se me rekomandim të IKShPK-së po përcjellin vlerat e manganit, po mirëmbajnë fazat e trajtimit, kanë shtuar kujdesin në procesin e trajtimit sipas procedurave standarde operative, kujdes të shtuar në procesin e dezinfektimit, shpëlarja e rrjetit të shpërndarës të gypave magjstralë dhe segmenteve të vogla, dhe qytetarëve në zonat në përcjellje të vazhdueshme t'u sigurohet uji



higjienik. Edhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) e ka njoftuar popullatën

se është duke vazhduar përcjellja në vazhdimësi e cilësisë së ujit në liqenin akumulues të Badocit të destinuar për pije. "Analizat e

fundit laboratorike tregojnë për rënie të vlerave referente të manganit në ujin e liqenit dhe në rrjetin shpërndarës, por që ende nuk janë arritur vlerat sipas standardeve të parapara në Udhëzimin Administrativ nr. 10/2021 - Cilësia e Ujit për konsum nga njeriu", ka njoftuar IKShPK-ja.

Ekipe të IKShPK-së janë në terren 24/7 dhe po bëhen çdo ditë analiza fiziko-kimike të ujit të prodhuar në fabrikën që furnizohet nga liqeni akumulues i Badocit dhe qytetarët do të njoftohen me kohë për normalizimin e parametrevë referentë të ujit të pijshëm.

Oficeri i FSK-së fiton vendin e dytë në garën "Virbus Unitis 2023" në Kroaci

Prishtinë, 10 nëntor - Oficeri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Emir Vllasa, është radhitur i dyti në garën "Virbus Unitis 2023" në Republikën e Kroacisë. Lajmi është bërë me dije në një komunikatë të lëshuar nga FSK-ja. "Nëntoger Emir Vllasa, pjesëmarrës nga Kosova në garën Military Crossfit

Competition 'Virbus Unitis 2023' që është mbajtur në Republikën e Kroacisë, në garën shumëfiduese, ku pjesëmarrës ishin njësi të ndryshme të sektorit të sigurisë, ushtarakë, policë, njësi speciale intervenuese, forca detare, zjarrfikës, gardianë etj., ka arritur rezultate të larta, duke u

radhitur i dyti në kategorinë ku ishte pjesëmarrës. Gara ishte individuale dhe e ndarë në kategori në bazë të moshës dhe gjinisë. Oficeri Vllasa në kategorinë 35-40 vjeç arriti të grumbullojë pikë dhe të radhitet në vendin e dytë dhe të shpërblehet me 'Medaljen e argjendtë', theksohet në njoftimin e FSK-së.



Gjenden mbetje mortore në Tusuz të personave të zhdukur gjatë luftës

Prizren, 10 nëntor - Gërmimet e filluara të premten në Tusuz kanë rezultuar me gjetje të mbetjeve mortore potencialisht të viktimave të luftës.

Në kuadër të zbatimit të planit të punës, nën koordinimin e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, njësitet e Drejtorisë së Policisë për Hetimin e Krimeve të Luftës, ekspertët mjekoligjorë të Institutit të Mjekësisë Ligjore, me mbështetjen edhe të ekspertëve të EULEX-it, janë duke kryer gërmimet

vlerësuese në tri lokacione në hapësirat e 'Varrezave të qytetit të Prizrenit'.

Gërmimet e filluara në mëngjesin e së premtes tanimë kanë rezultuar me gjetjen dhe zhvarrosjen e mbetjeve mortore që mund t'u përkasin viktimave të luftës që vazhdojnë të jenë në Listën e Personave të Zhdukur.


Mbetjet mortore të zhvarrosura do të dërgohen në Institutin e Mjekësisë Ligjore për ekzaminimet e nevojshme dhe identifikimin përmes analizës shkencore të

ADN-së.

Pasi të përfundojnë të gjitha procedurat do të përcaktohet numri i individëve të zhvarrosur dhe identiteti i tyre.

Gërmimet në Tusuz të Prizrenit janë duke u kryer në zbatim të urdhërësës së Gjykatës Themelore të Prishtinës, Departamentit Special.

Lokacioni në Tusuz të Prizrenit është lokacioni i trembëdhjetë i adresuar në kuptim të gërmimit vlerësues gjatë këtij viti brenda territorit të Republikës së Kosovës.



Rashiti: Pa njohje nuk ka normalizim të mirëfilltë

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Drejtori i Grupit Ballkanik për Politika në Prishtinë, Naim Rashiti, thotë se Qeveria e Kosovës e ka parë të pranueshëm draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe nuk ka asnjë arsye ta vonojë zbatimin e tij.

Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", ai thekson se nuk i di detajet e draft-statutit të Asociacionit, por konsideron se koncepti i tij bazohet në rendin kushtetues dhe ligjor të Kosovës dhe në nevojën për t'i adresuar nevojat bazike për qytetarët serbë. Sipas tij, pajtimi për draft-statutin është një proces politik që kërkon përmbyllje me garanci, që është në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe nuk është detyrimisht e nevojshme që ai të dërgohet sërish për vlerësim në këtë gjykatë. "Besoj se ambasadori e ka draftin. Unë nuk e kam dhe nuk mund ta komentoj. Ajo çka duhet të flasim është që Asociacioni është konform një procesi të dialogut për normalizimin dhe është bërë një instrument i marrëdhënies së Kosovës me Perëndimin, sikur që ishte Ahtisari. Kjo është më shumë për ta shtyrë, për ta rritur mbështetjen ndërkombëtare, në një farë forme për t'i bashkërenduar politikat me faktorin kyç ndërkombëtar, siç janë: ShBA-ja, Gjermania, Franca dhe vendet e tjera - ndoshta më pak me



instrumentin e BE-së, shërbimin e politikës së jashtme", ka theksuar Rashiti, duke shtuar se kjo do ta vë Kosovën në një situatë shumë më të mirë në raport me aktorët, sepse ata do të rreshtohen për ta mbështetur Kosovën qoftë në aspektin e sigurisë, qoftë në aspektin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare. "E dyta, detajet e vogla në substancën e saj edhe mund të mos jenë shumë të rëndësishme, sepse po flasim

për një instrument për disa fusha të caktuara. Dhe, asnjëherë nuk është menduar të ketë kompetenca ekzekutive, si i tillë që është në kuadër të këtij dialogu. Po të kishim folur për njohje reciproke, besoj se edhe elita politike kosovare do të kishte qenë më e hapur për të folur detaje të tjera, për procese të tjera. Por, po flasim në kuadër të këtij procesi të dialogut dhe nuk është menduar asnjëherë të ketë kompetenca ekzekutive. Do

të jetë një trup koordinues, bashkërendues", është shprehur Rashiti.

Ai thekson se zbutja e retorikës së BE-së ndaj Serbisë, pas sulmit të grupit të armatosur ndaj Policisë së Kosovës, më 24 shtator, në Banjskë të Zveçanit, ndodh për shkak se "Serbia kontrollon Raportin e progresit dhe gjuhën e dokumenteve të Bashkimit Evropian të cilat i referohen Serbisë".

Duke folur për kompromisin në

këtë proces dialogues, ai ka thënë se në çdo rrethanë, që nga fillimi i dialogut, kompromisi i këtyre proceseve ka qenë i lidhur me dy parametra. "Parametrat esenciale për serbët e Kosovës, arsimin, shëndetësinë, çështjet e identitetit nacional, marrëdhëniet me shërbimet prej Serbisë, pensionet e shërbime të tilla. Nuk shoh në asnjë rrethanë diçka më shumë. Tema është rritur kur faktori ndërkombëtar ka lejuar Serbinë ta rrisë ambicien e saj, dhe kompromisi - çfarëdo që do të mund të ndodhë - ka qenë i lidhur me njohjen e Kosovës nga ana e Serbisë, me njohjen reciproke. Dhe, po të kishim njohjen reciproke nuk do të flisnim shumë për elemente të vogla të vijave të kuqe. Por, meqë nuk ka njohje, nuk ka normalizim të mirëfilltë. Atëherë, flasim për elemente të rendit kushtetues dhe realisht i kthehemi procesit 2013-2015 e tutje. Siç e tha edhe zonja (ish-përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme, Catherine) Ashton në vizitën e saj, kurrë nuk është menduar që Asociacioni të jetë një mollë shërri, një problem kaq i madh. Është menduar t'o akomodojë nevojat bazike të qytetarëve serbë brenda Kosovës dhe besoj se aty do të kthehemi, por do të kthehemi dhe do të ketë sukses nëse i rrekemi punës për zbatim", ka thënë Rashiti.

Universiteti i Prishtinës bëhet me Qendër për Studime të Avancuara

Prishtinë, 10 nëntor - Në mbledhjen e fundit të Këshillit Drejtues të UP-së, është marrë vendim për themelimin e kësaj qendre, përmes së cilës synohet bashkëpunimi me universitete dhe institute kërkimore për kërkime shkencore elitare.

Krijimi i Qendrës për Studime të Avancuara në Universitetin e Prishtinës e

lehtëson procesin e integritimit në nisma rajonale dhe evropiane, të cilat kanë për qëllim kultivimin e një mjedisi të përbashkët për zhvillim të kërkimeve shkencore dhe të aplikuar në zbatim të praktikave më të avancuara akademike.

Qendra do ta stimulojë debatin intelektual dhe akademik të mbështetur në kërkim shkencor të avancuar

dhe ndarje të përvojave dhe perspektivave nga kërkues shkencorë nga rajoni dhe kërkues nga e gjithë bota me interesim shkencor në tematikat dhe kontekstin e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Si pjesë e shërbimeve që do të ofrojë qendra do të jetë edhe mundësia e studimeve pasdoktorale për kërkuesit shkencorë nga e mbarë bota.



Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën vlerëson arritjet në Ministrinë e Industrisë

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Republika e Kosovës, sipas Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për periudhën qershor 2022 - qershor 2023, ka bërë përparim të dukshëm, në veçanti duke plotësuar kornizën legjislative në përputhje me direktivat e BE-së, të hartuara nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, po ashtu me rritjen e performancës së Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë - KIESA-së për vitin 2022, duke e quajtur përmirësimin të fuqishëm, si dhe në përmirësimin e dukshëm të mbikëqyrjes së tregut.

Nëpërmjet kapitujve të Raportit të Progresit përmendet puna e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Te kapitulli i lëvizjes së lirë të mallrave, vlerësohet miratimi i Ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve dhe Ligji për Mbikëqyrjen e Tregut në përputhje me kornizën ligjore të BE-së, miratimi i Ligjit për Inspektime që ka rritur përgjegjësinë e Inspektoratit dhe ka unifikuar rregullat për produktet joushqimore.

Ndërkaq te fillimi i zbatimit të Programit për Zvogëlim të Barrierave vlerësohet miratimi i legjislacionit në përputhje me EU acquis, në veçanti përmenden aktet normative për pajisjet me presion, pajisjet me gaz, pajisjet e mbrojtjes dhe produktet e ndërtimit.

Te licencimi i 9 laboratorëve testues dhe 9 trupave inspektues theksohet realizimi i 2 830

inspektimeve për siguri të produkteve, shqiptimi i 311 gjobave, procedimi i 195 lëndëve dhe konfiskimi i 5 705 produkteve të dëmshme.

Te liria e lëvizjes së shërbimeve është vlerësuar puna në zbatimin e planit pesëvjeçar të direktivës evropiane të shërbimeve dhe formimi i grupit punues ndërministror me qëllim të monitorimit të zbatimit.

Te kapitulli i së drejtës së kompanive është vlerësuar miratimi i dy akteve nënligjore si fillim i zvogëlimit të dallimit në harmonizim përmes udhëzimit për regjistrim të bizneseve dhe atij për regjistrimin e zyrave të kompanive të huaja dhe miratimi i Kodit për Qeverisje Korporative në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe parimet e OECD-së për qeverisje korporative.

Në hartim e sipër Ligji i ri për Shoqëritë Tregtare, që synon harmonizim të mëtejme me legjislacionin e BE-së, duke theksuar faktin se do t'i trajtojë çështjet si kapitalin fillestar të bizneseve, të drejtat e aksionarëve, aspektet e publikimit të informatave të bizneseve dhe degëve të tyre.

Te kapitulli i pronësisë intelektuale/pronësia industriale është vlerësuar miratimi i 5 ligjeve dhe 7 udhëzimeve administrative si dhe veprimet e ndërmarra nga Inspektorati në zbatim të legjislacionit të kësaj fushe.

Sa i përket kapitullit për politikën sektoriale, Industrinë dhe NVM-të, vlerësohet qartë hartimi i Strategjisë ambicioze për Zhvillim Industrial dhe Mbështetje të Bizneseve, përgatitja e analizave të



strukturuara të sektorëve industrialë, përmirësimi i performancës së KIESA-së për vitin 2022, duke përmendur termin përmirësimi i fuqishëm/theksuar.

Gjithashtu, në raport është vlerësuar organizimi i një numri të madh të aktiviteteve që kanë promovuar bizneset dhe organizimi i panairëve të shumta të bizneseve.

Po ashtu, vlerësimet ka marrë edhe rritja e investimeve të huaja për

vitin 2022, me 43.6 % për periudhën janar - shtator 2022, përfshirja e Kosovës në programin e BE-së "Tregu i Përbashkët", zgjerimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore dhe rritja e portofolit të kredive për NVM-të, miratimi i Ligjit për Parqet Industriale dhe Teknologjike, miratimi i Ligjit për Investime të Qëndrueshme.

Në raport theksohet se sa iu përket çështjeve tregtare, Kosova ka bërë përparim në zbatimin e

planit të veprimit të tregut të përbashkët rajonal. Po ashtu, vlerësohet nisja zyrtare e negociatave me shtetet e EFTA-s për tregtinë e lirë dhe mbajtja e dy raundeve të negociatave, me përparim të mirë në të gjitha fushat, harmonizimi i Ligjit për Mallra Strategjike me legjislacionin e BE-së dhe harmonizimi i listës së mallrave me përdorim të dyfishtë sipas Rregullores së BE-së dhe listave të BE-së, kjo e fundit në baza vjetore.

Nënshkruhet marrëveshja 13.2 milionë euro për rehabilitimin e ujërave të zeza



PRISHTINË, 10 NËNTOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Hekuran Murati, së bashku me drejtorin e Zyrës për Kosovë të Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), Moritz Reme dhe kryeshefin e kompanisë rajonale të Ujësllësit Prishtina, Arsim Fetahu, nënshkruan të premtën një marrëveshje me vlerë 13.2 milionë euro për trajtimin e ujërave të zeza në kuadër të projektit "Përshtatja e zhvillimit urban me kushtet klimatike dhe menaxhimi i ujërave të zeza në Prishtinë".

Mbështetja financiare e nënshkruar i shtohet marrëveshjes fillestare të grantit me vlerë 28.8 milionë euro e nënshkruar në dhjetor të vitit 2022 duke e bërë

vlerën totale të grantit 42 milionë euro.

Qëllimi kryesor i projektit është përmirësimi i infrastrukturës së ujërave të zeza me synim garantimin e cilësisë së ujit dhe përmirësimin e shërbimeve publike të cilat u ofrohen qytetarëve të Kosovës.

Projekti, ndër të tjera, siguron se zhvillimi urban në Kosovë realizohet në përshatshmëri me ndryshimet klimatike dhe standardet ndërkombëtare për cilësinë e ujit. Përgjatë ceremonisë së nënshkrimit të dyja palët shprehën përkushtimin për zbatimin e projekteve aktuale si dhe thellimin e mundësive të bashkëpunimit në të ardhmen.

Bie numri i shitblerjes së banesave në Prishtinë

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Instituti GAP ka publikuar një infografikë përmes së cilës

tregon shitblerjen e pronave banesore në Kosovë në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021.

Duke u bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, GAP-i ka ndërtuar një

infografikë sqaruese. Sipas GAP-it, numri i shitblerjeve të banesave ka pësuar rënie.



Rrencat e pushtetit dhe brekëlëshuarit e opozitës!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Nuk ka Asociacion, nuk ka Zajebnicë, nuk ka Serbi, por ka autonomi substanciale në Kosovë dhe Metohi: Albin Kurti ia drodhi Makiavellit dhe të Urtëve të Sionit për mënyrën se si erdhi në pushtet. Nuk la mënyrë pa përdorur dhe pa keqpërdorur deri te hapja e varreve të paplanifikuara. E bëri një fushatë në të cilën edhe Gebelsi do të dilte karikaturë. E zbatoi përpikërisht formulën e Çerçillit për shumë djersë dhe shumë gjak. Vetë derdhi shumë djersë, fatmirësisht jo edhe gjak. Ishte anemik në atë kohë, gjakun e derdhën të tjerët. Pas përfundimit të luftës në Kosovë askush nuk e ka merituar më shumë pushtetin se që e ka merituar Albin. Rreth vetes mblodhi budallenj ordinerë me koeficient të lartë të inteligjencës. Pastaj i veshi me pushtet. Adresa e llogaridhënies së tyre ishte vetëm Albini, jo populli, aspak votuesit e as hipotetikiisht opozita e tredhur. Nëse ju tredhin të tjerët, keni arsytim shkencor për impotencën e veprimit, opozitar apo qytetar. Nëse shkaku i pushtetit e luani rolin e të tredhurit, mos u habitni kur punën tuaj e bëjnë të tjerët, shalimin e keni të garantuar dhe të merituar. Nga shoqëria civile i integroi ata me një të kaluar serbe dhe jugosllave që edhe tani angazhohen për rikthim të mirëqenies së munguar jugosllave dhe serbe në Kosovë ndonëse janë bërë milionerë pikërisht në Kosovën e çliruar dhe të shpallur të pavarur nga “shkatërruesit e shtetit”. Albin Kurtit ia heq kapelën për humanizëm të jashtëzakonshëm, ia siguroi bukën e gojës projugosllavit dhe proserbit të dikurshëm, ëndërrimtarit të pashuar të së kaluarës duke e zgjedhur këshilltar kryesor, së bashku me rob dhe robinja! Nuk ka si Albini. E bëri ministre për Politikë të Jashtme një person që ka probleme të brendshme, krejtësisht të brendshme. E bëri ministër një person që patologjikisht e urren luftën dhe ushtarët e UÇK-së, nga

pozicioni i një udhëheqësi të paramilitarëve mercenarë që kanë një kosto më të lirë se ata që luftuan për liri. I bëri deputetë dhe ambasadorë bijtë dhe bijat e spiunëve të dikurshëm dhe patriotëve të sotëm. Vetëm i ndërruan uniformat, nga JNA në UÇK. Nuk la udbash dhe udbashe pa rehatuar, dhe jo vetëm për sy dhe faqe, me bindje të plotë duke i cilësuar si ekspertë. E mbrojti integritetin territorial dhe sovranitetin e Republikës... deri në Tanzani. Të gjithë ata që e përkrahën kur pasuli hahej kokërr-kokërr i përmdoqi duke ua marrë vendin e punës, bukën, duke ua përndjekur fëmijët dhe familjen e disa edhe deri në varr. E bëri një armatë të madhe sahanlëpirësish, në shërbim të atdheut... Kurtistanit. Që nuk bëjnë asgjë përveç se i lehin çdo karvani që kalon afër tyre dhe që nuk ecin rrugës së zotit të tyre... Albin Kurtit. E shpalli veten student ngelcan të Bacë Adem Demaçit, dishepull të Ibrahim Rugovës, kushëri politik të Hasan Prishtinës dhe Robespier të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit duke e mbrehur tehun e gijotinës në Hagë që po rri mbi kokat e tyre! Opozita nuk ka përgjegjësi për bisedime dhe vendimet që dalin nga këto bisedime, por opozita ka përgjegjësi nëse fsheh faktet apo propozimin që prodhojnë pasoja për Kosovën dhe qytetarët e saj. Dhe këtë e kanë bërë pikërisht pas takimit me Lajçakun. Vazhdojnë ta mbajnë gojën mbyllur për përmbajtjen e draftit. E kanë frikën në palcë të cilën po e arsyetojnë me ruajtjen e konfidencialitetit. E kritikojnë propozimin, kërkojnë transparencë, me të drejtë nga KM i Kosovës, ndërkaq edhe kur kanë informata, nuk guxojnë ta hapin gojën. Në këtë rrafsh janë të njëjtë me Albin Kurtin, madje përgjegjësia e tyre është më e madhe. Si opozitë do të duhej ta përdornin këtë çështje si mundësi të artë për ta goditur pozitën për shkak të mungesës së transparencës për shkak të territ informativ në kohën kur edhe vetë po e rritin këtë terr informativ. Është krim opozitar, qyqarllëk i pashembullt, dhunim i parimit dhe veprimit opozitar. Po të kishte Albin Kurti vetëm pak mbetje nga e kaluara e vet opozitare, nëse asgjë nuk do ta bënte atëherë, së paku do të duhej të dilte para qytetarëve dhe t’ua tregonte të vërtetën, ashtu si është, e mirë apo e keqe.

E ka detyrim njerëzor, institucional, ligjor dhe moral. Detyrime kombëtare më nuk ka, askush më nuk ngarkon me këtë. Albini e ka trashëguar Zajebnicën, por që tash e ka transformuar dhe avancuar në autonomi substanciale. Asociacioni i Komunave Serbe në Kosovë tash është vetëm pretext teknik për një përmbajtje reale të cilën e ka pranuar dhe nuk mund ta refuzojë, autonomia substanciale. Në këtë rrafsh pajtohem me KM e Kosovës, Albin Kurti, se nuk ka Zajebnicë.

Përrallat, jo të Ezopit, por të ambasadorit Hovenier: Drafti i Asociacionit po shndërrohet në një dokument i dalë nga një mbledhje e masonëve, është i paqashtëm për publikun apo qytetarët që konsiderohen të padenjë për ta pasur këtë dokument. Çdonjëri që ka 1 gram tru e ka të qartë se diçka që është e mirë, nuk fshihet, madje ekspozohet, ku duhet dhe ku nuk duhet. Albini po thotë se ky propozim është i mirë, siguron njohjen de facto nga Serbia. Edhe kryemashtruesi i Kuvendit thotë se aty diku, në një pikë, pas leximit sipërfaqësor e ka vërejtur se ky propozim është plotësisht në përputhje me Kushtetutën. Dhe se ky del siguron njohjen de facto nga Serbia. Çfarë rrenci! Opozita flet zi e terr për këtë propozim por kur e ka lexuar, u bënë albina të vegjël, as gëk e as mëk! Lëshuan brekët poshtë gjunjëve. Ramushi e përkrahu Kurtin që e pranoi marrëveshjen. Për asociacionin tha se është në përputhje me Kushtetutën. Pasi ia dha Lajçaku për fast reading, Ramushi tha se Serbia duhet të lavdërohet se ndjehet fituese pas këtij propozimi. Pasi ia zuri derën ambasadori Hovenier Ramushi u bë albinushi (Albini i vogël) dhe opozita, nuk e tha asnjë fjalë. Për mua është shqetësuese që Ramushi, me përgatitje universitare të juristit, bën aq shumë ndryshime në qëndrime. Unë nuk marrë vesh në çështje juridike prandaj nuk ma zënë për të madhe. Ramushit kjo nuk i falet. Ndërkombëtarët po flasin për autonomi substanciale që ua garanton statuti i Asociacionit duke thënë gjithashtu se është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Prijatari për këtë është Hovenier, lojtari dhe arbitri kryesor në këtë lojë të Asociacionit, pa praninë e shikuesve. Ambasadorët tjerë janë si ata mbledhësit e topave

jashtë fushës së futbollit që topat e mbledhur ia dorëzojnë lojtarit kryesor apo arbitrit, zotit Hovenier. Ju kujtohet sigurisht, lexues të nderuar se si i ndryshojnë qëndrimet ambasadorët pasi ta përfundojnë mandatin. Kështu do të ndodhë edhe me Hovenierin. Madje, përveç se thotë se Asociacioni është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Kosovës, rreptë i kritikon të gjithë ata që nuk pajtohen me vlerësimin e tij duke thënë se po flasin pa e parë farë dokumentin në kohën që këtë dokument e ka bërë të padukshëm kurse opozitës ua ka mbyllur gojën, pa të drejtë të thonë as: “mirë dita - dobar dan”. Ambasadori Hovenier e ka të qartë se çdo gjë që e kaq vulën amerikane në Kosovë nuk guxon të kundërshtohet përveç ndonjë Don Kishoti budalla. E ka të qartë se edhe nëse dokumentin e Ilija Garashaninit “Naçertanija” e dërgon Hovenieri në Gjykatë Kushtetuese, jo që nuk do të kundërshtohet si një dokument antikombëtar por do të deklarohet se është një dokument ideal për bashkim kombëtar! Të poshtëruar dhe të mjerë, aspak të fyer! Me këtë Hovenier po ia siguron Albinit një profakturë për të blerë kohë. Edhe Albini e do pikërisht këtë! Derisa të dihet fati i përcaktuesit kryesor të zhvillimeve politike në Kosovë dhe Serbi, Aleksandar Vuçiqit. Të huajt nuk e kanë hallin te Albini apo opozita kosovare por te Vuçiqi. Edhe pas rastit të Manastirit të Banjskës, ndërkombëtarët po e konsiderojnë Vuçiqin si faktor stabilizues kurse Albin Kurtin si faktor destabilizues por, që të dy si të pazëvendësueshëm, Vuçiqi në Serbi, Albini në Kosovë. Albinit nuk i hoqën sanksionet kurse Vuçiqit nuk i futën sanksionet. Kjo flet mjaftueshëm për pozicionin aktual që e kanë. Vuçiqi u lirua nga Radojiçiqi dhe Vulini sikur që i detyroi serbët të pranojnë tabelat RKS dhe ky ishte sinjal i mjaftueshëm që ndërkombëtarët ta falin nga sanksionet. Po të bënte Albin Kurti ate që e ka bërë Vuçiqi, ndërkombëtarët do ia fusnin sanksione që as ujë për të pirë nuk i kishin dhënë. Hovenieri e ka të qartë sikur që duhet ta kenë edhe këta shylebylat tanë se në asnjë dokument që e ka prezantuar bashkësia ndërkombëtare nuk parashihet njohja de facto e Kosovës nga Serbia për aq kohë sa Kosova,

sipas Kushtetutës së Serbisë është pjesë përbërëse e Serbisë. Merr vesh Glok bin Sherif dhe qyqet e rremit që e vajtojnë të njëjtën temë, njohja e garantuar de facto e Kosovës nga Serbia. Nëse nuk ndodhë ndonjë mrekulli ndërkohë dhe nëse nuk ringjallet magjistari Hudini, Kosova po shkon drejt federalizimit të brendshëm dhe çështja e Kosovës nuk përfundon me këtë marrëveshje por shtyhet për së paku dhjetë vjet. Pas dhjetë viteve askush më nuk do të merret me Kosovën sikur që tani Ukraina ka rënë në Ligën e dytë të interesimit për shkak të zhvillimeve në Gazë. Në mungesë të një dokumenti që do të na bind për atë çka e thotë ambasadori Hovenier, fjalët e tij i ngajjnë përrallave të Ezopit dhe tregimeve të Andersonit. Mirëpo, Hovenieri i shoqëruar me hovenierët pakurizorë vendas e kanë një armë të fuqishme të mbushur me municion që nuk të mbytet menjëherë por të siguron vdekje të ngadalshme dhe në margjina duke ju shpallur si antiamerikanë. Këtë ligësi po e merr edhe LV duke bërë përpjekje ta arsyetojnë Zajebnicën dhe Albinin se tash kur po e dëgjon Hovenierin (Amerikën) po e sulmojnë se është bërë bashkëpunues me amerët dhe Amerikën. Zoti ua shtoftë gjajretin dhe i faltë për ate që po e bëjnë dhe e dinë se nuk është e mirë që po e bëjnë!

Lexues të nderuar, tani, besoj shumë se e keni të qartë se Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe të tjerët nuk është e rastit pse tash dhe në këtë kohë janë në Hagë!

Dy kubëza për një mozaik të paradoksit: E para: shkova me e regjistruar veturën pas mesazhit nga MINT. Pasi dorëzova dokumentacionin e nevojshëm m’i kërkuan dëshmitë e pagesës. Iu thashë se jam me leje të Xheluas dhe se na ka liruar nga pagesa. Mërrsh, izadji napolje, nisi ti ni Zoran, ni Millan, ni Dragan. U ktheva prapa në realitet, shqiptar gjithmonë i diskriminuar si shqiptar. Veturën e regjistrua, pasi hoqa dorë nga Xhelali. E dyta: më befasoi për qafimi dhe afërsia e përzemërt e KM Kurti me Emanuel Makron, president i Francës, pa u votuar ligji që i rregullon këto çështje në Kuvendin e Kosovës. Fajtori kryesor është grupi i deputetëve kundërshtues!

Kosova 'speciale'



Nga Bekim ÇOLLAKU

Vetëm disa ditë më parë, hetuesit e Zyrës së Prokurorit Special që funksionon në kuadër të Dhomave të Specializuara të Gjykatës Speciale të Kosovës me seli në Hagë, bastisën dy atdhetarë, publicistë dhe shkrimtar të mirënjohur në Kosovë. Këta të dy, kanë përjetuar, mbijetuar dhe luftuar regjimin diskriminues të Millosheviçit.

Në Kosovën e lirë dhe shtet, ata as në ëndërr nuk kanë mundur të paramendojnë trokitjet e forta në shtëpitë e tyre një ditë, e lere më që ato të mbushën me hetues dhe policë ndërkombëtarë. Arsyeja se përse ata kanë ngelur të tronditur nga "bastisja speciale", ndërlidhet me gjithë jetën dhe veprimtarinë e tyre në shërbim të paqes dhe shtet-ndërtimit. Ata të dy, i kanë kushtuar një jetë të tërë edukimit, emancipimit të shoqërisë sonë dhe kanë kryer me nder punën e tyre në shërbim të lirisë dhe shtet-ndërtimit. Mirëpo, duket se "mëkati" i tyre i vetëm ishte fakti që ata të dy ishin dhe mbeten miq e bashkëpunëtor të ish-presidentit të Kosovës z. Hashim Thaçi. Si duket, ky fakt ka qenë i mjaftueshëm që këta të dy, dhe shumë të tjerë që kanë qenë bashkëpunëtor të ish-presidentit Thaçi, të kthehen në shënjestër të monitorimit konstant dhe bastisjeve speciale. Kosova është një shtet i krijuar bazuar në

parimet dhe vlerat perëndimore. Prandaj, është krejtësisht e panevojshme dhe paradoksale që trokitjet e forta, bastisjet dhe akuzat speciale drejtohen kundër brezit të fundit qind për qind pro-amerikan dhe pro-perëndimor.

Kuvendi i Kosovës i ka dhënë ligjshmëri të plotë Dhomave të Specializuara për të nxjerr të vërtetën lidhur me pretendimet dhe akuzat të cilat pasuan si rrjedhojë e një raportit kontrovers të miratuar nga Këshilli i Evropës. Mirëpo, një gjë e tillë, nuk nënkupton devijim nga mandati dhe fushëveprimi i saj special i përcaktuar me ligj. Kritikta publike për mungesë transparence dhe këtë gjykimin maratonik që është duke ndodhur, nuk guxon të kthehet në hakmarrje apo cenim të lirisë së shprehjes dhe mendimit të lirë. Fatkeqësisht, lehtësia me të cilën kryhen këto bastisje kundër personaliteteve me kredibilitet të lartë publik dhe shtetëror, është e tmerrshme. Këto veprime të kryera nga bashkësia ndërkombëtare në emër të Kosovës dhe drejtësisë, sigurisht që mund të nxisin dyshime serioze lidhur qëllimet e tyre përfundimtare. Ndërsa, heshtja e shoqërisë dhe institucioneve tona në kontekst të këtyre bastisjeve, është e frikshme. Thjesht, askujt nuk i bëhet vonë nëse cenohet dhe njolloset kaq vrazhdë kredibiliteti dhe nderi i

personaliteteve publike dhe shtetërore. Mjerisht, të krijohet përshtypja se mjafton që personalisht të mos jenë subjekt i këtij trajtimi special. Turp i madh!

Shtetet e lindura nën kujdesin apo syrin vigjilent të ndërkombëtarëve, duket se kanë një trajtim të veçantë. Si pasojë, ato shpesh mbesin në një lloj laborator politik, ku "zgjidhjet speciale" ofrohen si ilaçe për të gjitha problemet e tyre. Një fat i tillë, po e përcjell Kosovën e cila ende nuk po arrin dot të bëhet një shtet që funksionon në mënyrë normale. Kosova vazhdon të mbetet një laborator interesant dhe poligon trajnues ndër të tjera, edhe për bastisje speciale.

Nuk kemi nevojë të kthehemi shumë mbrapa në histori, por që nga marrëveshja e Rambujesë, Kosova është shembulli par ekselencë i këtij trajtimi special ndërkombëtar. Për më shumë se dy dekada, Kosova ka kaluar nga njëra zgjidhje "sui generis" në tjetrën – nga statusi i saj i veçantë si territor nën administrimin e OKB-së, pavarësia e mbikëqyr e tek dialogu me Serbinë të cilit nuk ia dinë fundin askush. Aktualisht, jemi në fazën kur Kosova duhet të themelojmë një asociacion special për komunat me shumicë serbe në Kosovë, sepse ato nuk duan të bëhen anëtare të asociacionit ekzistues të komunave të Kosovës. Sigurisht,

se një themelimi i një asociacion të tillë special, do të prodhojë efekte apo ndoshta edhe pasoja speciale në të ardhmen për Kosovën. Në rastin më të mirë, do ta prolongoj Kosovën do bëhet një shtet normal, kurse për skenarin tjetër, nuk ia vlen të spekulohet.

Përgjatë gjithë kësaj periudhe të gjatë të shtet-ndërtimit, disa nga këto zgjidhje speciale të imponuara nga faktori përcaktues ndërkombëtar, kanë qenë tepër të favorshme për Kosovën. Nuk është se nuk na ka pëlqyer të kemi një trajtim të veçantë si shtet. Këtë cilësim e kemi përdorur si argument kryesor të prezantimit tonë shtetëror në arenën ndërkombëtare. Padyshim, ne kemi bërë një rrugëtim mjaft të gjatë dhe të suksesshëm së bashku me partnerët tanë ndërkombëtar. Mirëpo, zhvillimet e fundit që ndërlidhen me imponimin e zgjidhjeve speciale në kuadër të dialogut me Serbinë dhe gjykimin maratonik të Gjykatës Speciale me seli në Hagë, duket se do të na shtyjnë që si shoqëri të mendojmë se ka ardhur koha që Kosova të jetë vetëm një shtet normal. Asgjë më shumë!

Kosova është shpallur si shtet i pavarur duke iu falënderuar përkrahjes ndërkombëtare. Mirëpo partnerët duhet ta kuptojnë se nuk ka nevojë për më shumë "zgjidhje speciale". Kosova ka nevojë për njohje, integrim

dhe trajtim si çdo shtet tjetër – me të drejta dhe përgjegjësi të plota. Ajo ka nevojë për partnerë që e shohin jo si një eksperiment social apo politik, por si një partner të barabartë në arenën ndërkombëtare. Fatkeqësisht, Kosova sot ndodhet nën sanksionet e imponuara nga Bashkimi Evropian, dhe është shteti i vetëm në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropë (përjashtoj Rusinë dhe Bjellorusinë) që ende nuk e ka fituar statusin e vendin kandidat për anëtarësim në BE. Prandaj, pyetja e pashmangshme që shtrohet është se si e mundur që përkundër të gjitha këtyre zgjidhjeve speciale të komunitetit ndërkombëtar, Kosova mbetet e fundit në të gjitha përjekjet e saja për integrim në BE dhe NATO? Për një vend që ka luftuar për liri dhe për të qenë pjesë e komunitetit ndërkombëtar, ironia qëndron në faktin se sa më shumë Kosova synon normalitetin, aq më shumë i ofrohen zgjidhje 'të veçanta'. Ndërsa botës i pëlqen të trajtojë Kosovën si një rast të veçantë, ajo që vendi ka nevojë është një trajtim normal. Normaliteti do të thotë të merresh seriozisht si një shtet sovran, jo si një subjekt që vazhdimisht duhet të përshtatet me zgjidhje të reja dhe të pazakonta. Tani është koha që BE-ja dhe NATO ta lejojnë edhe Kosovën të troket butësisht në dyert e tyre.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Pesë futbollistë nga Superliga në listën e Kosovës për ndeshjet e nëntorit

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Primoz Gliha, e ka publikuar listën e futbollistëve për ndeshjet e muajit nëntor. "Dardanët" do të përballen me Izraelin të dielën më 12 nëntor, tri ditë më vonë luajnë ndaj Bjellorusisë. Ndeshjen e fundit Kosova e zhvillon për këtë muaj më 18 nëntor kundër Zvicrës. Në listën e përzgjedhësit Primoz Gliha janë 23 të ftuar, derisa shihet mungesa e kapitenit Amir Rrahmani dhe anësorit Edon Zhegrova, derisa janë ftuar plot pesë futbollistë nga Superliga e Kosovës: Kenan Haxhihamza (Dukagjini), Lumbardh Dellova dhe Qëndrim Zyba (Ballkani) dhe Ilir Krasniqi dhe Muhamet Hyseni (Llapi). Një emër i ri në listën e "dardanëve" është sulmuesi i talentuar i Lausannes, Alban Adini. Derisa janë ftuar edhe Meriton Korenica dhe Ermal Krasniqi. Rumania me 16 pikë të grumbulluara nga tetë ndeshje e kryeson Grupin I, kurse Zvicra është e dyta me një pikë më pak, por gjithashtu ka edhe një ndeshje më pak të zhvilluar. Në vendin e tretë pozicionohet Izraeli me 11 pikë, me dy takime më pak të luajtura. Në pozitën e katërt është Kosova me shtatë pikë, ndërsa në vendin e pestë dhe të gjashtë është Bjellorusia, respektivisht Andorra me vetëm dy pikë.

Lista e futbollistëve: Arjanet Muriq, Bisa Bekaj, Kenan Haxhihamza, Fidan Aliti, Kreshnik Hajrizi, Lumbardh Dellova, Lirim Kastrati, Ilir Krasniqi, Florent Hadergjonaj, Ilir Krasniqi, Qëndrim Zyba, Florian Loshaj, Florent Muslija, Meriton Korenica, Elbasan Rashani, Muhamet Hyseni, Bernard Berisha, Zymer Bytyqi, Vedat Muriqi, Ermal Krasniqi, Mërgim Vojvoda, Altin Zeqiri, Alban Ajdini.

PORTIERË
ETRIT BERISHA
THOMAS STRAKOSHA
ELHAN KASTRATI

MBROJTËS
ELSEID HYSAJ
IVAN BALLIU CAMPENY
BERAT GJIMSHITI
ARLIND AJETI
ARDIAN ISMAJLI
FREDERIC VESELI
MARIO MITAJ

MESFUSHORË
YLBER RAMADANI
KRISTJAN ASLLANI
KEIDI BARE
KLAUS GJASULA
QAZIM LAÇI
NEDIM BAJRAMI

SULMUES
ERNEST MUÇI
MYRTO UZUNI
TAULANT SEFERI
JASIR ASANI
ARBOR MUJA
ARBOR MUÇOLLI
SOKOL CIKALLESHI
MIRLIND DAKU

LISTA E EKIPIT
KOMBËTAR "A"

MOLDAVI-SHQIPËRI
17 NËNTOR, 18:00
"ZIMBRU STADIUM"

SHQIPËRI-ISHUJT FAROE
20 NËNTOR, 20:45
"AIR ALBANIA" STADIUM

SHKURT

Malisheva mposhti Gjilanin

Skuadra e Malishevës ka shënuar fitore me rezultat minimal 1-0 kundër Gjilanit, në ndeshjen e parë të javës së 14-të në Albi Mall Superligën e Kosovës. Pjesa e parë e ndeshjes ishte e barabartë dhe skuadrat shkuan në pushim me rezultat 0-0. Edhe pjesa e dytë ishte thuajse barabartë në përjashtim të golit që vendasi e shënuan nga penalltia me anë të Drilon Hazrollaj, në minutën e 84-të. Malisheva pas kësaj fitore renditet në pozitën e katërt me 20 pikë, ndërsa Gjilani renditet i shtati me 14 pikë.

Zvicra grumbullon tre shqiptarë për ndeshjen ndaj Kosovës

Përzgjedhësi i kombëtares zvicerane, Murat Yakin ka publikuar listën e futbollistëve të grumbulluar për ndeshjet kualifikuese për Kampionatin Evropian. Në listën e Zvicrës janë ftuar tre futbollistë me prejardhje shqiptare. Granit Xhaka, Xherdan Shaqiri e Andi Zeqiri. Gjatë muajit nëntor, Zvicra do të zhvillojë tri ndeshje në kuadër të ciklit kualifikues për "Euro 2024". Më 15 nëntor do të përballen me Izraelin, si ndeshje e mbetur nga muaji i kaluar, teksa tre ditë më vonë do të pres në shtëpi Kosovën, në stadiumin që pritet të jetë i mbushur plotë. Zvicra do të përballen edhe me Rumaninë më 21 nëntor. "Helevetikët" kryesojnë Grupin I në kuadër të kualifikueseve për Kampionatin Evropian.

Daku: 2 ndeshje, për misionin e ëmbël

Sulmuesi Mirilind Daku është ftuar nga Kombëtarja e Shqipërisë për dy ndeshjet e fundit kualifikuese në Kampionatin Evropian "Euro 2024". "2 ndeshje, për misionin e ëmbël", ka shkruar Daku. Kuqezinjtë do të ballafaqohen me Moldavinë me datë 17 nëntor duke filluar nga ora 18:00. Ndërsa ciklin kualifikues e mbyllin ndaj Ishujve Faroe në "Air Albania" tre ditë më vonë, me fillim nga ora 20:45. Shqipëria e kryeson grupin E, me 13 pikë të grumbulluara nga gjashtë ndeshje. Në vendin e dytë në këtë grup është Republika Çeke me dy pikë më pak. Ndërsa në pozitën e tretë është Polonia me 10 pikë, por me një ndeshje më shumë të zhvilluar. Në vendin e katërt renditet Moldavia që një pikë më pak, gjersa Ishujt Faroe pozicionohen në pozitën e fundit me një sosh.

Vëllaznimi për fitoren e katërt radhazi, Peja të tetën

Gjakovë, 10 nëntor - Fundjava do të dhurojë sfidë interesante në Prince Caffé Superligën e Kosovës në basketboll. Përballja e parë do të jetë në mes të Vëllaznimit dhe Pejës. Kuqezinjtë ndodhen në formë të mirë. Kanë tri fitore radhazi, por në formë edhe më të mirë është Peja, që ka shtatë fitore në shtatë ndeshje, apo asnjë humbje në elitë, njëherësh edhe skuadra e vetme pa humbje në këtë edicion të Superligës. Takim, po ashtu, interesant do të zhvillohet të shtunën

SUPERLIGA - Java e 8

Të shtunën takohen:

17:00 Vëllaznimi-Peja

19:00 Bashkimi-Golden Eagle Ylli

Të dielën takohen:

17:00 Trepça-Istogu

19:00 Proton Cable Prizreni-Sigal Prishtina



mbrëma, ku Bashkimi ndeshet me Golden Eagle Yllin. Tashmë të dyja skuadrat kanë nga tri fitore e katër humbje dhe do ta kërkojnë fitoren e katërt për këtë edicion. Trepça pas humbjes nga Golden Eagle Ylli do të ndeshet me Istogun, që numëron një fitore e gjashtë humbje, kurse mitrovicasit

janë në vendin e dytë me pesë fitore e dy humbje. Java e tetë do të mbyllet me ndeshjen në mes të Proton Cable Prizrenit dhe Sigal Prishtinës, sfidë që do të zhvillohet në kryeqytet. Prizrenasit kanë dy fitore e pesë humbje, kurse prishtinasit kanë katër fitore e tri humbje.

Gjimshiti: Ishte ndeshje speciale për mua

BERGAMO, 10 NËNTOR - Atalanta siguroi kualifikimin për në fazën tjetër të Evropa Ligës. Golin vendimtar për bergamaskët e realizoi Berat Gjimeshi, për të cilin ishte një mbremje speciale, duke qenë

se luante ndeshjen numër 200 me fanellën e Atalantës. Pas sfidës, mbrojtësi i kombëtares u shpreh i lumtur që shënoi golin që vendosi ndeshjen ndaj Sturm Grazit. "Ishte një ndeshje speciale për mua, por

edhe bëhej fjalë edhe për ndeshje shumë të rëndësishme për skuadrën pasi në lojë ishte kualifikimi për në fazën tjetër. Jam shumë i lumtur që shënova golin vendimtar. Luajtëm mirë në pjesën e dytë,

pasi në të parën gabuam shumë. Ndaj Sportingut do të luajmë për të fituar, edhe pse bëhet fjalë për një skuadër të fortë. Gjithsesi, ne duam ta mbyllim grupin në vendin e parë", u shpreh Gjimeshi.



Lista e Shqipërisë për dy ndeshjet e fundit kualifikuese, mungon Broja

Tiranë, 10 nëntor - Moldavia dhe Ishujt Faroe janë dy kundërshtarët e fundit të Kombëtares shqiptare në fushatën e ndeshjeve kualifikuese, të vlefshme për një vend në finalët e Kampionatit Evropian "Gjermani 2024". Kuqezinjtë nisin grumbullimin zyrtarisht të hënën e 13 tetorit, teksa trajneri i Kombëtares, Silvinjo, ka thirrur plot 24 lojtarë për këto dy takime. Tekniku brazilian ka vendosur të mos bëjë ndryshime në portë, mbrojtje e mesfushë, duke u besuar të njëjtëve futbollistë të thirrur edhe në ndeshjet e kaluara të Kombëtares. E vetmja risi e Silvinjos është rikthimi i Arbnor Muçollit në radhët e kuqezinjve. Sulmuesi shqiptar po kalon një formë mjaft të mirë në radhët e skuadrës së Goteborgut në Suedi. Sakaq, të gatshëm për ta mbrojtur portën kuqezi, trajneri Silvinjo do t'i ketë Etrit Berishën, Thomas Strakoshën e Elhan Kastatin. Emrat që përbëjnë repartin e mbrojtjes janë Berat Gjimeshi, Ardian Ismajli, Ivan Balliu Campeny, Elseid Hysaj, Federic Veseli, Arlind Ajeti dhe Mario Mitaj. Në mesfushë e sulm teknik



i Kombëtares shqiptare ka thirrur plot 14 lojtarë, duke nisur nga Ylber Ramadani, Kristjan Asllani, Keidi Bare, Klaus Gjasula, Qazim Laçi, Nedim Bajrami, Ernest Muçi, Myrto Uzuni, Taulant Seferi, Jasir Asani, Arbnor Muja, Arbnor Muçolli, Sokol Cikallesi e Mirlind Daku. Trajneri Silvinjo do të dalë në një konferencë për medie nesër (11 nëntor, ora 11:00, në "Shtëpinë e Futbollit") për të folur në lidhje me listën dhe dy ndeshjet e fundit të Shqipërisë në këtë rrugëtim, ndërsa skuadra do të jetë e plotë në grumbullim duke filluar nga data 13 nëntor. Futbollistët që do

të përfundojnë më herët impenjimet me skuadrat e tyre do të paraqiten në grumbullimin që do të bëhet në Tiranë nga e diela, ndërsa seancat stërvitore do të zhvillohen në "Shtëpinë e Futbollit". Shqipëria do ta zhvillojë ndeshjen e parë të këtij muaji në transfertën e Moldavisë me datë 17 nëntor, me sfidën që nis në orën 18:00, ndërsa me 20 nëntor Kombëtarja do ta presë në stadiumin "Air Albania" përfaqësuesen e Ishujve Faroe, për ta përmbyllur kështu këtë edicion të kualifikueseve të Kampionatit Evropian "Gjermani 2024".

Indiana mposhti Milwaukee, Atlanta surprizon Orlandon

Atlanta, 10 nëntor - Dy ndeshje të luajtura ditën e fundit në NBA, por surprizat nuk kanë munguar. Skuadra e Milwaukee u mund jashtë fushës me rezultat 126-124 nga Indiana, në një ndeshje me shumë emocione dhe rivalitet deri në fund. Giannis Antetokounmpo realizoi 54 pikë e 12 rebounde për Bucksin, por që nuk mjaftuan për ta shmangur humbjen. Ky është edhe rekordi i pikëve i realizuar në një ndeshje në këtë fillim sezoni në NBA. Për Pacersin, tre lojtarë realizuan mbi 20 pikë. U dallua Haliburton me 29 pikë e 10 asistime, Mathurini me 26 pikë e Turneri me 21. Vendasit e nisën keq takimin, duke humbur periodën e parë me 14 pikë disavantazh, por më pas rikuperuan dhe në fund ia dolën t'i mposhtin pretendentët me 2



pikë para dhe ngjiten në vendin e tretë në Lindje. Në sekondat e fundit fiton edhe skuadra e Atlantës, që mposhti me rezultat 120-119 Orlandon, sfidë kjo vendosur nga basketbollisti Trae Young, që realizoi 41 pikë për

miqtë. Te Magic mungoi lojtari- lider, duke u mundur në fushën e vet në sekondat e fundit. Edhe kjo një sfidë plot rivalitet, ku vetëm qetësia në fund solli fitoren e Hawksit, që ngjitet në vendin e katërt në Lindje.

SHKURT

Zënka jashtë ringut, Joshua: Bëra për spital gjashtë veta

Anthony Joshua është një ndër boksierët më të mirë në histori. Anglezi ka zbuluar detaje interesante nga jeta e tij. Ai ka pasur disa zënka në jetën e tij jashtë ringut, ndërsa tani ka zbuluar detajet e një shërri në të cilën ishte aktori kryesor. Në një intervistë për "BBC", ish-kampioni i botës ka shpjeguar se nga i kanë ardhur plagët në dorë. "Unë nuk jam një person që futem në telashe, por ka një histori. Kam hyrë në një sherr në rrugë dhe kam pasur disa momente të këqija nga kjo. Shkova për të blerë një pulë të pjekur. Një natë situata përfundoi aty që unë u ndesha me gjashtë djem i vetëm. Ishte një luftë masive", ka thënë Joshua. "A i dërgova të gjashtë në spital? Në arkivol! Po bëj shaka, sigurisht", ka shpjeguar një nga boksierët më të mirë britanik të të gjitha kohëve.

Mourinho: Jam i zhgënjyer nga disa lojtarë

Trajneri i skuadrës së Romës, Jose Mourinho, u tregua i ashpër me ekipin pas humbjes 2-0 në Ligën e Evropës nga Slavia e Pragës. "Mungoi çdo gjë, nuk dua të flas shumë dhe askush të mos flasë. Një rezultat shumë i merituar për ta në kuptimin pozitiv, shumë i merituar për ne në kuptimin negativ. Nuk më pëlqeu asgjë. E kam folur tashmë me lojtarët në dhomat e zhveshjes, gjë që nuk e bëj kurrë. Ajo që thashë do të mbetet mes nesh, dua të jem i sinqertë dhe i drejtë me djemtë e Slavisë që e merituan", ka thënë Mourinho. "Asgjë nuk funksionoi. Nga pikëpamja individuale kishte shumë pak lojtarë me qëndrimin e duhur në fushë. Nga shumë lojtarë pashë një qëndrim jokorrekt për një ndeshje serioze", ka deklaruar Mourinho.

Reali heq dorë nga Mbappe, synon Haalandin

Real Madridi ka hequr dorë nga transferimi i Kylian Mbappes nga PSG-ja. "Cadena SER" raporton se gjiganti spanjoll ka hequr dorë nga francezi dhe tash synim kryesor e ka transferimin e sulmuesit të Manchester Cityt, Erling Haaland. Agentja e yllit norvegjez, Rafaela Pimenta, është parë të mërkurën në "Santiago Bernabeu", ku edhe mund të ketë diskutuar në lidhje me anëtarin e Cityt. Qendërsulmuesi Haaland ka kontratë me klubin anglez deri në vitin 2027, por një ofertë marramendëse nga Reali mund t'i ndryshojë gjërat.

Ricciardo: I lumtur që shpëtova, goma fluturoi mbi kokën time

Gara e fundit e Formulës 1 në Brazil pati një aksident të frikshëm në kthesën e parë, teksa u përplasën makinat e Alex Albon dhe Kevin Magnussen. Por nëse kontakti mes tyre ishte disi normal, ajo që trembi më shumë fansat ishte një gomë që fluturoi në pistë. Goma e makinës së Albon fluturoi mbi makinën e Daniel Ricciardo, duke e goditur atë në pjesën e pasme. "Pashë një aksident të madh para meje dhe në pistë kishte shumë mbeturina. Pashë një gomë që u shpëput dhe që nisi të fluturojë në ajër", kujton Ricciardo. "Mbam mend që instiktivisht ula kokën për të evituar që goma të më godiste në kokë edhe pse kisha sistemin 'halo' mbi kokë. Isha i lumtur që në atë moment goma nuk më goditi edhe pse ndjeva që diçka u prish pas meje dhe pashë që ajo gomë më kishte goditur makinën në pjesën e pasme, rreth gjysmë metri larg kokës time", ka shtuar Ricciardo. "Isha i mërzhitur pasi makina ishte dëmtuar dhe gara ime ishte kompromentuar, por nga ana tjetër isha i lumtur që ajo gomë nuk më goditi në kokë. Janë aksidente të garës që mund të kenë pasoja", u shpreh Daniel Ricciardo, që garon me Alpha Tauri.

Messi: Në PSG më mungonte fanella me numrin 10

Lionel Messi e ka pranuar se gjatë kohës së tij në Paris Saint-Germain i ka munguar fanella me numrin 10. Argjentinasi ishte mësuar me këtë fanellë në Barcelonë, por edhe me kombëtare, megjithatë kur u transferua në Paris numri 10

tashmë ishte në fanellën e Neymarit. Messi për këtë arsye gjatë kohës me PSG-në mbante fanellën me numrin 30. "Nuk mendoj se sot është aq e rëndësishme sa ka qenë kohë më parë por, padyshim, fanella me numrin 10 është ende e

veçantë", ka thënë Messi në bisedën me Zidanën gjatë një video për Adidas. "Kur isha në Paris nuk vishja fanellën me numrin 10. Epo, isha mësuar ta mbaja gjithmonë fanellën me numrin 10 të gjithë atyre viteve në Barcelonë, në kombëtare.

Megjithëse nuk ishte një punë e madhe, pak më ka munguar që të mos kisha 'numrin tim', apo jo? Sepse e kam veshur gjithë jetën, por është në rregull, pastaj u mësova. Dhe numri 30 ishte e veçantë edhe për mua. Fillova të luaja me numrin 30.

Loja ime e parë ishte me numrin 30, kështu që ka edhe diçka të veçantë", ka shtuar Messi. Argjentinasi është rikthyer sërish duke veshur fanellën me numrin 10 që kur iu bashkua Inter Miami në korrik.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shkamb Muhaxhiri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Gentian Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Hana Gjemajlaj, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "ARKITEKT SINANI".

- Gezim Sadiku, shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "ISMAIL QEMALI".

- Muhamet Veseli, shpall të pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III,IV dhe diplomën e shkollës së mesme "ARKITEKT SINANI".

- Muhamet Preteni, shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "TREPÇA", STANTERG.

- Shaban Bunjaku B.I, shpall të pavlefshme arkën fiskale PEF me numër: DG06600094, nr-biznesit: 811543687.

- Gjeral Ukaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dëshmorët e Korishit " Korishe.

- Alorent Magi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme të Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Tomë Marku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Dëshmorët Lleshi".

- Halil Rugova nga Istogi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike " Nexhmedin Nixha".

- Donart Ibrahimimi shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- Lulzim Musa shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- "Idea A" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811447996.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

